REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr.3264 prot. Gramsh, më 10 /08/2026

**VENDIM**

Nr.47 datë 10.08.2026

**"PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR.08, datë 12.02.2026 "PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2026"**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; neni 8, pika 2, neni 9, gërma "b", të nenit 18 të Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"; VKM nr.108, datë 05.03.2014 "Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil, pika 2,3 dhe 11,13; Vendimit nr.25, datë 20.04.2026 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njësive vartëse të saj, për vitin 2026", të kryetarit të bashkisë; Vendimit nr. 08, datë 12.02.2026, "Për miratimin e planit vjetor të Pranimeve në Shërbimin Civil për vitin 2026" me propozim të Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore,

**VENDOSA:**

1. Të miratojë Planin e Pranimit për vitin 2026 në shërbimin civil të administratës së Bashkisë Gramsh sipas Tabelës bashkëlidhur që është pjesë përbërëse e këtij vendimi, prej 50 (pesëdhjetë) pozicionesh të shërbimit civil, nga të cilët:

a. 1 (një) pozicion i kategorisë së I-1, niveli i lartë drejtues

b. 2 (dy) pozicione të kategorisë II-2, niveli mesëm drejtues;

c. 9 (nëntë) pozicione të kategorisë III-3, III-2, niveli i ulët drejtues;

d. 12 (dymbëdhjetë) pozicione të kategorisë IV-3, IV-4, niveli ekzekutiv;

2. Plani prej 24 (njëzetë e katër) pozicionesh të shpallet në Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Ëeb-n e Bashkisë dhe stendën e afishimeve publike të Bashkisë, pas hyrjes ne fuqi të ketij vendimi.

3. Pas shpalljes publike, nga Njësia Përgjegjëse për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të nisin proçedurat për shpalljen e vendeve të lira dhe brenda 90 (nënëdhjetë) ditësh proçedurat e pranimit në shërbimin civil, nëpërmjet proçedurave të lëvizjes paralele e ngritjes në detyrë për:

a. 1 (një) pozicion niveli i lartë drejtues:

**1. Sekretar i Përgjithshëm;**

b.2 (dy) pozicione të nivelit të mesëm drejtues:

1. **Drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore;**
2. **Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mbrojtes Sociale;**

c. 9 (nëntë) pozicione të nivelit të ulët drejtues:

1. **Përgjegjes i Sektorit të Integrimit Europian, Projekteve dhe Komunikimit;**
2. **Përgjegjës i Sektorit të IT-së, Performancës dhe statistikave;**
3. **Përgjegjës i Sektorit të Administrimit te pronave publike;**
4. **Përgjegjës i Sektorit të Protokollit dhe Arkivës;**
5. **Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes Shoqërore;**
6. **Përgjegjës i Sektorit të Turizmit dhe Eventeve;**
7. **Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar;**
8. **Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm;**
9. **Përgjegjës i Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore**

d. 12 (dymbëdhjetë) pozicione të nivelit ekzekutiv:

1. Specialist auditimi;
2. Specialist IE, projekteve dhe komunikimit;
3. Specialist për mbrojtjen e fëmijëve (NJMF) Punonjës Social;
4. Specialist hartim projektesh;
5. Specialist Inxhinier;
6. Specialist për kontrollin e zhvillimit, investimet, burimeve natyrore, lejeve dhe licensave;
7. Specialist për vlerësimin financiar të aseteve vendore;
8. Specialist i ndihmës ekonomike NJA Pishaj;
9. Specialist i ndihmës ekonomike NJA Kukur;
10. Specialist i ndihmës ekonomike NJA Skëndërbegas;
11. Specialist për performance, statistikat dhe koordinator i së drejtës së informimit
12. Specialist për paga dhe shpenzime;

Adresa: Sheshi " Kamber Dermyshi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
SEKTORI JURIDIK DHE BURIMEVE NJERËZORE

Nr.3264/1 prot. Gramsh, më 10/08/2026

# PLANI VJETOR I PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL

## BASHKIA GRAMSH 2026

Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"; VKM nr.108, datë 26.02.2014 'Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", pika 2,3 dhe pika 11,13, janë identifikuar 24 (njëzetë e katër) vende të lira, për vitin 2026, pozicione sipas kategorisë, klasave, niveleve e grupeve në tabelën vijuese,

| Nr. kategoria | Emërtimi i kategorisë/klasës | Plani i pranimit viti 2026 | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Gjithsej | Pension | vend i ri | vakant |
| I-b | NC niveli i larte drejtues (klasa I) | 1 | - | - | 1 |
| II-b | NC niveli i mesem drejtues (klasa II) | 6 | - | - | 2 |
| III-a/1<br>III-b | NC niveli i ulet drejtues (klasa III) | 16 | - | - | 9 |
| III-b | NC kategoria ekzekutive (specialist) (klasa IV) | 27 | - | 1 | 11 |
| **TOTALI** | | **50** | **-** | **1** | **23** |

**KRYETARI**

**Besion AJAZI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA GRAMSH

Adresa: Sheshi " Kamber Dermyshi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

Për nivelin ekzekutiv, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të zhvillojë proçedurat për pranimin në shërbimin civil nëpërmjet lëzivjes paralele dhe pranimit për herë të parë në shërbimin civil.

4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Komisionet përkatëse për Lëvizjen Paralele, Ngritjen në Detyrë dhe Pranimin në Shërbimin Civil.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESION AJAZI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH